



**BASHKIA ELBASAN**  
**DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TE PYJEVE DHE KULLOTAVE**

*Adresa: Bashkia Elbasan, Rruga "Qemal Stafa", Tel.003555-3416.E mail:hoshkiaelbasan@elbasan.gov.al*

**PROJEKT PYLLËZIMI**  
**Krasta madhe**

Shërbimi Administrative	Rajoni Nr.5 & 6_Elbas
Qapullor i objektit	Krasta madhe
Ekonomia pyjore	'Zaranikë'
N/ngastra	124/a
ZK	8527



**BASHKIA ELBASAN**  
**DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TE PYJEVE DHE KULLOTAVE**

Adresa: Bashkia Elbasan, Rruga "Qemal Stafa", Tel.003555: 3416, E-mail: bashkiaelbasan@elbasani.gov.al

Miratohet

KRYETARI  
Gledian Llatja

Me urdher e porosi

Zv. KRYETARI  
Aulona Bylykbashi

PROJEKT PYLLËZIMI

Objekti : Krasta e Madhe  
Ek. Pyjore : Zaranikë  
Ngastra nr. 124/a  
ZK : 8527



Projektoi  
Sp. Sek. Menaxhimit

Ing. Qemal Poka

Kontrolloi  
P/Sek. Menaxhimit

Ing. Jakov Bodurri

Konfirmoi  
Drejtori

Shpëtim Çullhaj

Viti 2023

# Përmbajtja

Nr.	Përshkrimi	Faqe
o	<b>KONSIDERATA TE PËRGJITHËSHME, QËLLIMI DHE DETYRA E PROJEKTIT</b> Konsiderata të përgjithëshme, Qëllmi dhe detyra e projektit	4-5
o	<b>KAPITULLI I PARË</b> Njoftime të përgjithëshme Kufijtë natyralë, Sipërfaqja e përgjithëshme, Përdorimi i sotëm i objektit Vendosja gjeografike dhe administrative e objektit Kufijtë, rrjeti rrugor Historiku, përdorimi i sotëm i objektit Planvendosja Rrjeti rrugor dhe largësia nga qendra e banuar	5-7
o	<b>KAPITULLI I DYTË</b> Studim i përgjithëshëm i kushteve stacionale Cjeomorfologjia, forma e terrenit, gjeologjia Kundrejtimi, lartësia mbi nivelin e detit Hidrologjia Kushtet klimatike Regjimi i temperaturave Regjimi i reshjeve Regjimi i erërave Kushtet pedologjike (tipi i tokës dhe karakteristikat e saj) Bimësia ekzistuese	7-11
o	<b>KAPITULLI I TRETË</b> Zgjedhja e llojeve dhe përshkrimi tyre Metoda e pyllëzimit Skema e pyllëzimit, koha e kryerjes së punimeve	16-18
o	<b>KAPITULLI I KATËRT</b> Pyllëzimi, shërbimet, zëvendësime masat për mbrojtjen Skema e mbjelljes	19-20
o	<b>KAPITULLI I PESTË</b> Aspekte ekonomiko-financiare Preventiva punimesh	7-11 21-25

## **KONSIDERATA TË PËRGJITHËSHME, QËLLIMI DHE DETYRA E PROJEKTIT**

### **Konsiderata të përgjithëshme**

Mbështetur në ligjin nr. 8752, dt. 26.3.2011 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", (i ndryshuar), hartohet ky projekt pyllëzimi, si një dokument tekniko-ekonomik që plotëson hallkat procedurale të kërkesës për ripyllëzimin e Krastës së madhe.

Objekti është fond pyjor publik, i cili me Vendimin e Këshillit Ministrave nr. 433 dt. 8.6.2016, (i ndryshuar), është transferuar në pronësi të Bashkisë Elbasan. Bën pjesë në ekonominë pyjore "Zaranikë". Shtrihet në lindje të qytetit, afër fshatit Mengël, në anën e djathtë të rrjedhjes së Lumit Shkumbin.

Krasta madhe është pyllëzuar rreth viteve 1960 deri në vitin 1980 (161.5ha), me investime nga buxheti i shtetit, kontributin e qytetarëve elbasanas, ndërmarrjeve shtetërore dhe nxënësve të shkollave të qytetit. Deri në vitin 1990 në këtë objekt janë kryer trajtime silvikulturore nëpërmjet të cilave janë prodhuar produkte pyjore, si lëndë ndërtimi, hynj perimesh, rrëshirë pishe, esenca të halave të pishës, e të tjera.

Pas vitit 1990, qeverisja teknike dhe ajo ligjore e pyllit mori trajtën e liberalizimit. Përveç faktorëve natyror, veçanërisht atyre njerëzor, vit pas viti janë shkaktuar dëme të konsiderueshme kryesisht nga zjarri, prerjet e jashtëligjshme, zënia e tokës me ndërtime, mbjella e kulturave jopyjore, etj, ndërkohë që sipërfaqja pyjore tashmë po konvertohet në regjimin e bimësisë dhe shkurreve regresive.

Fenomenet natyrore dhe njerëzore kanë ndikuar negativisht dhe kanë bërë të mundur ndërprerjen e evolucionit progresiv të grumbullit duke e çuar atë drejtë evolucionit regresiv të tij. Erozioni, sidomos në pjesën e sipërme ka shpëlarë shtresën aktive të tokës, duke krijuar proska dhe në disa raste shkëmbi amnor ka dalë mbi sipërfaqen e tokës.

Në këto kushte, duke mbajtur parasysh faktin që Krasta është edhe 'park periferik i qytetit', por edhe si masë për mbrojtjen e tokës nga erozioni, masave zbutëse të ndikimit në mjedis, etj, arsyetohet se zgjidhja më e drejtë dhe urgjente është ripyllëzimi i saj, në mënyrë që të sigurojmë një mbrojtje sa më të mirë të tokës, të krijojmë kushte për qëndrueshmërinë e pyllit dhe tokës, ruajtjen e biodiversitetit, rritjen aftësisë ripërtëritëse, për të përmbushur funksionet ekologjike, ekonomike dhe sociale, për të krijuar një masiv pyjor jo vetëm me vlera ekonomike, por edhe estetike e mjedisore.

#### **Qëllimi i Projektit**

- Projekti ka për qëllim të përcaktojë rrugët më efektive dhe ekonomike për vlerësimin e terrenit, të sipërfaqeve të degraduara dhe çeltirave, për ripyllëzimin me kultura pyjore të cilat garantojnë zhvillimin e pyllit të ri, në mënyrë që jo vetëm të sigurojmë mbrojtjen e tokës nga gërryerjet, por të krijojmë një masiv pyjor me vlera të mëdha ekonomike dhe shoqërore; zhvillim të qëndrueshëm të grumbullit, për të përmbushur funksionet ekologjike, ekonomike dhe shoqërore, për sot dhe për të ardhmen.
- Nisur nga gjendja ekzistuese dhe urgjenca, rehabilitimi i tokave të degraduara në Krastë do të krijojë sipërfaqe pyjore me vlera të veçanta të peisazhit, për rritjen e rolit ekologjik dhe mjedisor, duke u bërë pasuri e biodiversitetit. Llojet që do të përdoren për pyllëzimet e reja plotësojnë funksionin mbrojtës, prodhues, me ndikim në mjedisin natyror.
- Nëpërmjet këtij projekti do të shpejtohen fazat e zhvillimit të bimësisë duke zëvendësuar artificialisht shoqërimet bimore spontane me të tjera shoqërimet bimore me vlerë ekonomike dhe estetike, në mënyrë që të ndryshojnë kushtet klimaterike e tokësore, si dhe mjedisi natyror i Krastës.
- Tashmë pylli i Krastës, vlerësohet jo vetëm për prodhimtarinë e materialit drusor, por edhe si objekt me funksion të veçantë për mbrojtjen e klimës, tokës, ujrave, ajrit, të elementëve higjieno-shëndetsor, njëherësh edhe si 'park periferik' i qytetit, në funksion për pushimin, argëtimin, shlodhjen, edukimin dhe turizmin për qytetarët elbasanas.

#### **Detyra e projektit**

- Është rehabilitimi i pyjeve artificialë të degraduar, krijimi shoqërimet bimore nëpërmjet ripyllëzimeve me halor mesdhetar të natyralizuar, të kombinuar me lloje tjera si Selvi, Tunjë dhe fletorë gjethe mbajtës, në përshtatje me faktorët klimaterikë dhe tokësor.
- Detyra kryesore e këtij projekti është që në përputhje me kushtet stacionale të objektit, të realizohen punimet e nevojshme dhe sigurimi i kushteve optimale për zhvillimin jetësor të fidanave, deri në instalimin e pyllit të ri.
- Zgjidhja përfundimtare e problemit për rehabilitimin e Krastës, është ripyllëzimi i sipërfaqeve të degraduara, shërbimeve kulturore, ripërtëritja natyrore nëpërmjet farës, masave mbrojtëse nga veprimtaria njerëzore dhe faktorëve natyror, ndalimi i kullotjes, si dhe sensibilizimi e ndërgjegjësimi i popullatës për rreth.

## KAPITULLI I PARË


### Njoftime të përgjithshme

#### Vendosja gjeografike dhe administrative e objektit:

Objekti ndodhet anën e djathtë të rrjedhjes të Lumit Shkumbin, 5km në lindje të qytetit të Elbasanit, në afërsi të fshatit Mengël dhe linjës hekurudhore Elbasan-Prrenjas. Bën pjesë në Ekonominë Pyjore "Zaranikë", i cili me Vendimin e Këshillit Ministrave nr. 433 datë 8.6.2016, (i ndryshuar), është transferuar në pronësi të Bashkisë Elbasan dhe administrohet nga kjo Bashki nëpërmjet Strukturës të Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Veterinarisë dhe Mjedisit.

- **Kufijtë natyralë:** Referohu koordinatave dhe Planvedosjes në Ortofoton pasardhëse.
- Veri Kufizohet me kurrizin\_nënngastra nr. 124/a
- Jug Sipërfaqe me bimësi pyjore/ Ish tokë në përdorim e Nd. Krimbit të Mëndafshit
- Lindje N/ngastra nr. 124/b
- Perëndim Rrugë autopjore/ N\_ngastra nr. 125/a.

**Sipërfaqja e përgjithshme e objektit:** që do të pyllëzohet, është 11.0 ha. Kryesisht në çeltira të krijuara nga djegia, thyerja dhe rrëzimi i pishave, siç pasqyrohet në ortofoton vijuese dhe fotot në shtojcën nr. 1.



#### Përdorimi i sotëm i objektit:

Kjo sipërfaqe pyjore tashmë e xhveshur për shkak të fenomeneve të lartpërmendura, djegies nga zjarri, reshjeve të dëborës, shoqëruar me erërat e forta të luginës së Shkumbinit, sistemit rrënjor, përbërjes së tokës, e të tjera, kurorëndësia e pyllit ka zbritur ndjeshëm duke krijuar kushte të favorshme për zhvillimin e shkurreve, si Driza, Mreta, Shqopa, Gjineshtra, Manaferra, etj.



**BASHKIA ELBASAN**

DREJTORIA SHËRBIMIT PYJOR, BUIQËSISË, VETERINARISË DHE MIJEDISIT

## ORTOFOTO PLANVENDOSJA E OBJEKTIT TË PËLLËZIMIT NË KRASTËN E MADHE



### Legjenda:

Objekti **Krasta madhe**  
**N/ngasira 124/a**

Sipërfaqja që do të pëllëzohet: 11.0ha.  
Lloji: 8P+1Selvi & Tunjë+1llqe

### Koordinatat:

- ① 41°06'46''N, 20°06'42''E
- ② 41°06'53''N, 20°06'39''E
- ③ 41°06'55''N, 20°07'02''E
- ④ 41°06'51''N, 20°07'03''E
- ⑤ 41°06'47''N, 20°06'58''E
- Lartësia mes. mbi det' 199m.
- Lartësia 190-195m (Brezi mbrojtës nga zjarri 5-8m gjërësi)

Specialisti Admin.-Menaxhimit PK

*Qemal Paka*

P./ Sektorit të Admin.-Menaxhimit PK & Extensionit  
Jalov Bodurri



*Shpëtim Çullhaj*



**BASHKIA ELBASAN**

DREJTORIA SHËRBIMIT PYJOR, BUIQËSISË, VETERINARISË DHE MIEDISIT

## PLANVENDOSJE

E OBJEKTIT TË PYLLËZIMIT NË KRASTËN E MADHE (N\_NGA STRA NR.124/A)\_EKONOMIA PYJORE 'ZARANIKË',  
FRAGMENT HARTE EKONOMIA PYJORE 'ZARANIKË'



### SHpjegues:

**Ekonomia Pyjore:** 'Zaranikë'  
**Fshati:** L.'5Maji' Mengël/ NJA\_ Rajoni Nr. 5  
**Emri i vendit:** Krasta madhe  
**Objekti:** Krasta madhe / N\_ng nr. 124/a  
**Zona Kadastrale:** 8527  
**Koordinatat:** 41°07'11.8"N, 20°06'32.4"E  
**Promësi:** Publike / Bashkiake  
**Lloji që do të mbillet:** P. mesch.+ tjera  
**Skema e mbijelljes:** 3x2m  
**Nr. fidanave/ha:** 1666 fidana/ha.  
**Mosha e fidanave:** 2-3 vjeçar/ në qeska sipërfaqja që do pyllëzohet: 11.0ha.  
**Nr. fidanave/objekt:** 18236 fidana.

- Kufi ngastre pyjore
- Rrugë autopjore/kryesore
- Objekt pyllëzimi
- Koordinatat në ortofoton pasuese

Specialisti Admin.-Menaxhimit PK

*Qemal Paka*

P/. Sektorit të Admin.-Menaxhimit PK & Extensionit

Jakov Bodurri

DREJTORI

Shpëtim Çullhaj



Projekti Pyllëzimi\_Objekti Krasta madhe\_Elbasan



### Rrjeti rrugor dhe largësia nga qendra e banuar:

Krasta përshkohet nga rrugë të përhershme dhe sezonale pothuaj në të gjithë teritorin e saj. Deri në rrafshnaltë rruga është e asfaltuar, ndërsa në brendësi dhe periferi të saj ka disa rrugë autopajore të kalueshme pathuaj në çdo stinë të vitit. Në majën e Krastës ndodhet një objekt kulti, i cili është mjaft i frekuentuar jo vetëm nga besimtarët vendas. Meqenëse ndodhet në afërsi të qytetit, në ditë festash popullore, por çdo ditë Krasta frekuentohet nga qindra pushues, adhurues të natyrës dhe atyre që ushtrojnë aktivitete fizike.

### Sipërfaqja e ndarë sipas kategorisë së përdorimit të teritorit e nëngastës nr. 124/a.

Tabela Nr. 1

№	Ekonomia pyjore	N_ngastra	Kategoria e përdorimit të teritorit				Sipërfaqja që do të pyllëzohet (ha)
			Pyll (ha)	Djerr (ha)	Tokë me bimësi pyjore	Inproduktive (ha)	
1	Zaranikë	124-a	51.0	0.0	0.0	0.0	11.0
		124-b	19.0	0.0	0.0	0.0	0.0
		124-c	0.0	0.0	20.0	0.0	0.0
	<b>Shuma:</b>		70.0	0.0	20.0	0.0	11.0

### Historiku i punimeve të kryera:

Pyllëzimet e Krastës kanë filluar në sipërfaqe modeste në vitet 1956-'60 me investime nga buxheti i shtetit, kontributin e qytetarëve të Elbasanit, nxënësve të shkollave dhe ish ndërmarrjeve të qytetit, prej të cilëve deri në vitin 1980 janë pyllëzuar 161.5ha, kryesisht me pishë.

Grumbulli përbëhet nga llojet e halorëve mesdhetar dhe bashkëshoqërime në çeltira, nënpyll të llojeve Shkozë e zezë, Mretë, Shqopë, Drizë, Vidh, Trëndafil i egër, Gorricë, Lofatë, Dëllënjë e kuqe, Gjineshtër, Manaferrë dhe fletorë të tjerë. Por, fatkeqsisht prej shkaktarëve të sipërcituar, sipërfaqje të konsiderueshme me pyll, tashmë po konvertohen në sipërfaqe me bimësi pyjore barishtore dhe shkurre. Ndaj, situata e krijuar kërkon marrjen e masave të menjëhershme për rehabilitimin e tokës pyjore, tashmë në degradim.

## KAPITULLI I DYTË KARAKTERISTIKAT STACIONALE

### PËRDORIMI I TERITORIT

Edhe pse nuk renditet në parqet e qytetit, Krasta ka karakter rekreativ dhe përdoret nga qytetarët si park natyror periferik. Tashmë pylli i Krastës vlerësohet jo vetëm për prodhimtarinë e materialit drusor, por edhe si objekt me funksion të veçantë për mbrojtjen e klimës, tokës, ujrave, ajrit, elementëve higjieno-shëndetsor me funksion të veçantë pushimi argëtimi, shlodhjeje, edukimi, turizmi, etj.

### Kundrejtimi:

Objekti është shpat, mesatarisht i pjerrët në drejtimin juglindor.

### Lartësia mbi nivelin e detit:

Kuota më e lartë e Krastës është 292.2m (Maja Krastës) me koordinata: 41°07'11.8"N, 20°06'32.4E, ajo masatare 216m, ndërsa kuota më e ulët është 140m mbi nivelin e detit. Pjerrësia mesatare e terrenit është 15°.

### Hidrologjia:

Objekti përshkohet nga një prroskë, e cila gjatë periudhës së dimrit favorizon zhvillimin e erozionit, (jo shumë aktiv), por me masat që do të merren është plotësisht i mundshëm stabilizimi i tij.

### Kushtet klimatike/ Përshkrimi i klimës: ①

Objekti bën pjesë në zonën klimatike nënzona fitoklimatike mesdhetare tranzitore centrale, ku në gjysmën e ftohtë të vitit mbizotërojnë masa ajrore kontinentale, ndërsa gjatë gjysmës së ngrohtë mbizotërojnë masa ajrore detare. Elementët përbërës të klimës paraqesin regjimin e karakterizuar nga dimra të ftohtë por jo shumë të ashpër. Bën pjesë në zonën fitoklimatike Lauretum, nënzona e ftohtë.

### Regjimi i temperaturave:

Janë të zonës mesdhetare kodrinore, nënzona qëndrore, zona fitoklimatike e shkurreve mesdhetare (Lauretum).


Interes të veçantë paraqesin ekstremet e temperaturave me amplituda vjetore. Vlerat e amplitudave vjetore në këtë zonë janë 17 e 21°C. Amplitudat ditore janë të mëdha në mes të 8.2-13.2°C. Amplitudat me vlerat më të mëdha gjatë muajve korrik-gusht janë 23.5 dhe 23.9°C. Amplituda vjetore, vlerat më të vogla i ka gjatë vjeshtës dhe dimrit, kryesisht gjatë dhjetorit dhe janarit.

TEMPERATURAT MESATARE		°C
Vlerat e amplitudave vjetore në këtë zonë janë		17 e 21°C
Vlerat e amplitudave vjetore në këtë zonë janë		17 e 21°C
Maximumet absolute të temperaturës së ajrit gjatë muajve korrik-gusht		40,8°C
Amplituda vjetore, vlerat më të vogla i ka gjatë vjeshtës dhe dimrit		
Kryesisht gjatë dhjetorit e janarit		
Temperatura mesatare vjetore lëkundet mesatarisht		14,7°C
Temperatura mesatare e muajit më të ngrohtë (Gusht)		23,9°C
Temperatura mesatare e muajit më të ftohtë (muajit Janar) është		6°C
Temperatura mesatare e maksimumeve ditore është		32°C
Temperatura mesatare e minimumeve ditore është		4°C
Minimumet absolute të temperaturës ulen		0 deri -6°C
Periodha me temperaturë mesatare < se 10°C zgjat 6-6.5 muaj Fillon 15		
deri ne 30 Mars dhe vazhdon deri nga mesi i dekadës së tretë të muajit		
Nëntor.		
<b>Reshjet:</b>		
Sasia e reshjeve vjetore lëkundet nga 1000-1127 mm, të cilat janë në		
formë shiu.		1000-1127mm
Moti karakterizohet me dy muaj thatësi (Korrik-Gusht).		
Temperaturat absolute °C		minimumi -14°C maksimumi +40,8°C

### Temperaturat mesatare të ajrit dhe rreshjet mesatare mujore

Temperatura mesatare e ajrit në °C (Mesatare 35-vjecare 1931-1965)														
Stacioni	M u a j t												Mes.	Amplituda
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII		
Temperatura mesatare e ajrit në °C	5,8	7,2	9,8	13,6	17,5	21,2	24,0	24,4	21,3	16,4	11,8	7,8	15,1	18,6

### Grafiku i temperaturave mesatare mujore e vjetore



#### Maksimumet absolute të temperaturës së ajrit

Stacioni	M u a j t												Vjetore
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	
Objekti	17,6	24,6	25,4	29,0	35,0	38,5	39,3	40,8	36,9	32,3	25,4	22,5	40,8

#### Minimumet absolute të temperaturës së ajrit

Stacioni	M u a j t												Vjetore
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	
Max. absolute te temperaturës se ajrit	-14,1	-8,4	-8,0	0,4	4,0	6,3	10,9	10,0	5,0	2,6	-6,3	-7,4	-14,1

#### Temperatura mesatare e maksimumeve mujore

Stacioni	M u a j t												Vjetore
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	
Objekti	15,4	19,	21,4	26,0	30,1	33,7	36,0	36,7	32,5	28,6	22,5	18,6	37,3

#### Reshjet:

Faktorët kryesor që kushtëzojnë sasitë, shpërndarjen vjetore, mujore e stinore të reshjeve në përgjithësi, janë pozicioni gjeografik dhe veçoritë e relievit. Zona ku shtrihet objekti ynë karakterizohet nga një numur relativisht i madh ditësh me reshje duke ju afruar në këtë drejtim asaj të zonës malore. Sasia mesatare vjetore e reshjeve shumëvjeçare e mujore për lartësinë 200-350m arrinë në 1157mm/vit.

**Regjimi i reshjeve** përbën faktorin më të rëndësishëm klimatik për mbarëvajtjen e kulturave pyjore që do të instalohen në këtë objekt. Zona ku përfshihet objekti rregjistron mesatarisht 1157m/m reshje vjetore, në rreth 99 ditë. Kjo shpërndarje favorizon deri në një farë mase zhillimin e kulturave pyjore të instaluara. Siç shihet dimri është stinor, me reshje më të shumta që arrijnë 373m/m.


Kjo zonë karakterizohet nga reshje mesatare jo vetëm në periudhën e vjeshtës por edhe në periudhën e pranverës. Reshjet në përgjithësi nuk kanë karakter torrencial siç mund të karakterizohen në zonat e tjera të vendit.

Pavarësisht nga reshjet mesatare vjetore, në Krastë vërehen periudha të thata dhe të lagëta. Sasitë e reshjeve vjetore dhe siguria në përqindje e reshjeve gjatë gjysmës së ngrohtë si dhe maximalet e minimalet, raporti ndërmjet tyre jepet në grafikët e mëposhtëm.



## Përmbledhë e treguesve të temperaturave dhe reshjeve mesatare mujore dhe vjetore

Shërbimi Meteorologjik	Temperaturat dhe Reshjet mesatare												
	Janar	Shkurt	Mars	Prillë	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tëtor	Nëntor	Dhjetor	Mesatarja vjetore
Temperaturat mesatare mujore dhe vjetore °C	5,8	7,2	9,8	13,6	17,5	21,2	24,0	24,4	21,3	16,4	11,8	7,8	15,1
Reshjet mesatare mujore dhe vjetore mm	112	133	109	84	90	55	30	35	83	113	131	128	1103



Grafiku Termo-Pluviometrik i zonës së studimit\_Krastë

### Regjimi i erëave:

Në objektin e marrë në studim, gjatë gjysmës së ftohtë të vitit dominojnë masa ajrore kontinentale, ndërkohë që gjatë gjysmës së ngrohtë dominojnë masa ajrore detare. Krasta rrihet me erëra që vijnë nga gryka e Shkumbinit dhe malësia e Polisit. Erërat që fryjnë në këtë zonë zakonisht arrijnë shpejtësi të madhe, mesatarja vjetore sillet 1.4-1.6 m/sek, por ajo që vihet re është numuri i rasteve deri në 34.7%. Përsa i përket drejtimit, dominojnë erërat e lindjes, të cilat kanë shpejtësi mesatare 1.6 m/sek. Më pak të vrullëshme janë erërat që fryjnë nga perëndimi dhe jugu 0.9-1.5 m/sek. Është për t'u theksuar se erërat e periudhës së verës e favorizojnë zhvillimin e bimësisë të instaluar dhe asaj që do të pyllëzohet.

### KARAKTERISTIKAT E ERËRAVE DHE LAGËSHTIA E AJRIT ② NË KRASTËN E MADHE\_ELNASAN




Fig. Nr.1. Karakteristikat e erës dhe lagështia e ajrit.

①

Burimi të dhënave: Instituti Hidrometeorologjik "Klima e Shqipërisë", Tiranë 1975

### **Kushtet pedologjike (tipi i tokës dhe karakteristikat e saj):**

Toka në përgjithësi është e cekët, e hijtë kafe e kuqerremtë, gjysëm deri skeletike, me përbërje mekanike subargjilore, e rëndë e thatë, me strukturë. Shtresa e humusit arrinë deri 1.5-3cm.

Shkëmbi amnor është magmatik ultrabazik, gëlqeror/silicor. Gurët në sipërfaqe, nën 30% të saj.

Erozioni është i zhvilluar në sipërfaqe e në thellësi në formën e prroskave. Ka teksturë argjilore.

Në ndikimin e formacioneve gjeologjike dhe bimësisë, janë formuar toka të kuqerremta, të cilat kanë tipar dallues cektësinë, përmbajtjen me lëndë ushqyese dhe përbërjen mekanike të tyre.

Nga studimi i tokës dhe zhvillimit të bimësisë rezulton se në përgjithësi kushtet tokësore janë të favorshme për zhvillimin e kulturave drunore. Thellësia e tokës paraqitet jo shumë e cekët, thellësi kjo që shkon nga 25-30cm, ndërsa në pjesën e poshtme të objektit thellësia arrin 30-40cm.

Një tjetër faktor tokësor, është përmbajtja e lartë e materialit skeletor (gurë). Pjesmarrja tyre shkon nga 30-60% të sipërfaqes, kështuqë, së paku gjatë përgatitjes së tokës ky material duhet të largohet, për t'u zëvendësuar me shtresa më të trasha dhe shtresa fiziologjike me tokë tjetër të marrë përreth.

Ndikimi i shkëmbit mëmë dhe përbërja mekanike, sidomos në gëlqeror, formon toka të rënda. Përsa i përket përmbajtjes së lëndës ushqyese dhe sipas klasifikimit agronomik këto toka përgjithësisht janë të varfëra në humus, ku në horizontet në thellësi dhe përmbajtja e humusit ulet në mënyrë të ndjeshme.

Është karakteristikë e veçantë e këtyre tokave të varfëra në fosfor, që të paktën në vitet e para të merren masa për plehërime suplementare, me plehra kimikë, si Superfosfat, Dap, etj.


Reaksioni i tokës paraqitet në përgjithësi pak acid deri në bazik, kështuqë ndikimi në zhvillimin e kulturave pyjore, është i favorshëm.

### **Bimësia ekzistuese:**

Krasta shtrihet në zonën klimatike Lauretum. Vegjetacioni paraqitet në gjëndje mesatare dhe me pjesmarrjen e disa llojeve pyjore. Tipet aktuale të vegjetacionit janë të larmishme në lloje dhe kanë një shtrirje uniforme ku tipet kryesore aktuale të grumbullit përbëhen nga pisha e egër (*Pinus helepis L.*), Pishë deti (*Pinus pinaster L.*) pishë e butë (*Pinus pinea L.*), Tunjë (*Thunja orientalis*), Selvi (*Cupresus sempervirens*). Grumbulli pyjor është me prejardhje farore, pyllëzime artificiale me përbërje homogjene të llojeve mesdhetar.

Nënpylli, përbëhet me pjesmarrjen e llojeve Shkozë e zezë, Vidh, Cërmadell, Shqopë, Murriz, Drizë, Lofatë, Mretë, Gjineshtër, Gorricë, Dëllënjë e kuqe etj. Përhapja: pothuajse uniforme në 70% të sipërfaqes, me gradë mbullimi 30%, dhe dendësi më të madhe në kufirin jugperëndimor të sipërfaqes, pa fuqi lëndore.

Nën ndikimin e kullotjes, kushteve klimaterike e toksore dhe erozionit, bimësia barishtore në pjesën e sipërme të objektit paraqitet mesatarisht e rrallë, ndërsa në pjesën e poshtme është në gjendje më të mirë, me pjesmarrjen agronomike 30% graminace, listër, tërfill, gjemb, e të tjera.



②

Burimi informacionit: Arkivi i Drejtorisë Shërbimit Pyjor Elbasan dhe vëzhgimi në terren.

## KRASTA NË VITE (ARKIV)





Foto nga Arkivi Digital \_ Vitet e para të përlëzimeve në Krastën e madhe

Foto: Krasta e përlëzuar 1980



Shkulje e drurëve nga faktor natyror \_Foto e vitit 2017

Zjarri i vitit 2017

## KAPITULLI I TRETË ZGJEDHJA E LLOJEVE QË DO TË PËRDOREN PËR PYLLËZIM

### Zgjedhja e llojeve

Në zgjedhjen e llojeve për pyllëzim është marrë parasysh kombinimi i drejtë i tre elementëve kryesor:

① qëllimi i pyllëzimit, ② kushteve të mjedisit dhe ③ veçorive biologjike të llojit. Për zgjedhjen e llojeve pyjore jemi bazuar në metodën e ekologjisë së krahasuar. Kjo mënyrë zakonisht zbatohet për zgjedhjen e llojeve dhe prejardhjeve, kur nuk kemi ngritur eksperimente dhe kur rezultatet kërkohen për një periudhë kohore të shkurtër. Kjo metodë lejon përdorimin e prejardhjeve mbi bazën e krahasimit të kushteve të biologjisë së njohur të llojeve në vendin e tyre me mjedisin, duke marrë në konsideratë aftësisnë e tyre në përshtatje me kushte të reja të arealit ekzistues.

**Meqenëse objekti shërben edhe si 'pyllë park' për qytetarët, propozojmë bashkëshoqërime me Selvi, Tunjë, Ilqe, etj. të përshtatshme me kushtet ekologjike të zonës, të cilat përveç larmisë së llojeve do të shërbejnë edhe si breza mbojtës nga erërat e fuqishme të lindjes.**



### Përshkrimi i llojeve që janë zgjedhur për pyllëzim ③


#### **Pisha e egër (Pinus halepensis Mill.)**

Është dru jo shumë i lartë, rrallëherë arrin lartësi më të madhe se 20m, me diametër që mund të arrijë edhe mbi 1m. Aparati rrënjor është fillimisht boshtor, pastaj i formuar nga rrënjë shumë të thella, me fuqi të madhe depërtimi në plasaritjet e shkëmbit amnor. Kërçelli në përgjithësi është i shtrembër dhe përmban shumë rrëshirë. Lëvorja në ngjyrë gri të hinjtë në moshë të re, pastaj bëhet e murrme e kuqërremtë, çahet për së gjati në forëm pllakash të shumta. Dru me blanë të verdhë, të qartë dhe me myjë të murrme të errët, i rëndë, i qëndrueshëm, me shumë rrëshirë, me rrahë vjetor të dallueshëm mirë. Kurora është e rrallë, e ç'rregullt, piramidale e çlirët ose rruzullore e shtrirë, në ngjyrë të gjelbër të hapët. Lulëzon nga marsi deri në maj. Farat piqen në vjeshtën e vitit të dytë, përhapja e farave ndodh qysh në fillim të vitit të tretë, boçet e hapura qëndrojnë edhe për një kohë të gjatë mbi degë. Frutifikon herët, qysh në moshën 8-10 vjeçare edhe më përpara, por farat e kësaj periudhe nuk janë të mira.

Është lloj me kërkesa të pakta ndaj tokës, përshtatet në të gjitha tipet e terreneve, duke përfshirë ato gëlqerore të thata dhe u shmanget atyre argjilore të ngjeshura ose tepër të lagëta. Është lloj termofil, kserofil, dritëdashës, i ndjeshëm kundrejt të ftohtit gjatë dimrit kur temperatura qëndron disa ditë më poshtë se -5°C.



Është më rezistenti ndërmjet pishave, i kushteve ekstreme të nxehta e të thata të mjedisit mesdhetar. Ka përhapje të lehtë dhe rritet shpejt. Është lloj mesdhetar i pranishëm në të gjitha vendet e pellgut të Mesdheut, gjërësisht i kultivuar që nga koha e antikitetit, fakt që vështirëson së tepërmi dallimin e arealit natyror nga ai i kultivuar. Në vendin tonë formon grumbuj natyror të përzier me pishën e butë në Divjakë dhe Pish Poro, ndërsa e kultivuar është e përhapur në brezin pyjor bregdetar, në formacione shkëmbore gëlqerore e silicore të zonës Lauretum, siç është Krasta e Krujës dhe e Elbasanit. Shkon nga 800 deri në 1000m lartësi mbi nivelin e detit. Rezultatet shumë të mira të arritura deri tani në vendin tonë tregojnë qartë se kjo lloj pise mund të përhapet me sukses të plotë në të gjithë zonën e sipërpërmendur. Druri i saj gjen përdorim të gjërë në ndërtime, në fabrikat e përpunimit të drurit për prodhimin e lëndës së sharruar, të pllakave të zdrukthit, për shtylla miniere dhe amballazhe, në industrinë e letrës për pastë e celulozë. Në disa vende shfrytëzohet kryesisht për prodhimin e rrëshirës; lëvorja përdoret si lëndë tanifere.



Pishë e egër (*Pinus halepensis* Mill.)

Pisha e detit (*Pinus maritima* Poir)

### **Pisha e detit (*Pinus pinaster* L.)**

Rritet deri 30m lartësi. Ka sistem rrënjor boshtor të fortë. Është lloj i vendit në mesdheun perëndimor. Në vendin tonë gjendet vetëm i kultivuar. Në 20-vjeçarin e fundit ajo është përdorur për pyllëzimet e brezit bregdetar dhe në terrene të tjera, në toka të hijta kafe, mbi formacione shtufesh dhe serpentina të katit të dafinës. Nuk i përshtatet krahinave me reshje verore të larta. Kërkon klimë të tipit mesdhetar, në të cilën mund të përhapet deri në nënkatin e ftohtë të gështenjës.

Rritet në një zonë të gjërë tokash, por rritja më e mirë është në terrene të kulluara mirë. Mund të rritet në terrene gëlqerore pa dëm të madh si dhe në ranishtet në të cilat mund të shtrijë lirshëm rrënjët. Për rritjen e shpejtë kjo pishë ka nevojë për toka të përshkueshme. Përgatitja e tokës dhe skemat e mbjelljes në pyllëzime janë të njëjto me ato të pishës së egër. Për pyllëzimet preferohet të përdoren fidana me dhe' në rrënjë. Pisha e detit në vitin e parë formon rrënjë boshtore të zhvilluar. Në disa vende mbjelljet në pyllëzime përgjithësisht bëhen direkt me farë.

### **Selvia (*Cupressus sempervirens* L.)**

Është përdorur si dru zbukurues, në forëm njollash në disa objekte pyllëzimi me Pishë të egër gjatë bregdetit jonian, në Krastë të Elbasanit, etj. Zhvillohet mirë në klimë mesdhetare me reshje vjetore 300-1400mm dhe temperaturë mesatare vjetore mbi 10°C. Përshtatet në toka të ndryshme. Është lloj dritë e ngrohtësidashës. I reziston erës, të ftohtit. Zakonisht shumëzohet me farë, por edhe me llstarë e copa. Farat mbliidhen në shtator të vitit të dytë dhe duhet të grumbullohen vetëm nga drurë të varietetit horizontal. Në farishtore mbjelljet kryhen në vullaja ose qeska polietileni. Fidanat e prodhuara në vullajë pas 1 viti shpërngulen. Në pyllëzime mbjelljet kryhen me fidana 1-2-3-vjeçar (1F dhe 1 F+1-2 Sh). Zënie të mira arrihen kur mbillen fidane dhe me dhe' në rrënjë. Largësitë e mbjelljes janë 2x2 m deri 2x1 m. Shpesh mbillet i përzier me pishat dhe fletorët për të përmirësuar tokën.

### **Ilaja (*Quercus ilex* L.)**

Gjendet e përhapur në zonën mesdhetare kodrinore dhe në shpatet e ngrohta të asaj paramalore. Pëlqen toka të hijta kafe karbonatike, por rritet edhe në ato argjilo-ranore të thata, të varfëra dhe me gurë. Është lloj dritëdashës, por kërkon hije në moshë të re. I qëndron të nxehtit dhe thatësirave të mëdha të vendit tonë. Rritet ngadalë deri në moshat 15-20 vjeçare. Formon pyje të përzier me shkurret mesdhetare dhe me pak grumbuj të thjeshtë. Në ripyllëzime zakonisht mbillet direkt me farë, kurse për qëllime zbukurimi përdoren fidane. Përdoret për ripyllëzimin e tokave të thata gëlqerore dhe për të krijuar gardhe e mure të gjelbërt me forma të ndryshme mbasi duron shumë krasitjen.

### **Zgjedhja e skemës dhe formula e pyllëzimit:**

Për zgjedhjen e skemës dhe dendësisë së mbjelljes së fidanave jemi udhëhequr nga kërkesat e llojeve dhe kushtet mjedisit, por edhe nga normativat e miratuara në numurin e fidanave/ha. në objektet e pyllëzimit. Për rastin tonë është planifikuar që numuri i fidanave me llojin pishë të jetë 1666 fidana/ha dhe skema e pyllëzimit të jetë 3mx2m. Formula e pyllëzimit, 8 pishë mesdhetare + 2 të tjera (Selvi, Tunjë dhe Ilqe).


Zgjedhja e kësaj skeme është bërë në përshtatje me konfiguracionin e terrenit, kurorës të llojit, krijimit të kushteve të përshtatshme të hapsirës dhe dritës për zhvillimin normal të drurëve, instalimin e bimësisë barishtore si dhe eliminimin deridiku të ndërhyrjeve silvikulturale të mëvonëshme.

Kjo skemë do të realizohet kundrejt një piketimi profesional të gropave, nga dy punëtorë nën drejtimin e specialistit të pyjeve, ashtu sikurse parashikohet në preventivin e punimeve. Duhet patur kujdes që gjatë piketimit, të bëhet reduktimi i pjerrësisë, sipas tabelave të posaçme ose metodave të thjeshta të relizuara nga specialistë me përvojë. Reduktimi i pjerrësisë do të bëhet gjatë piketimit në përshtatje me konfiguracionin e terrenit.

Për përcaktimin e skemës dhe formulës së pyllëzimit si dhe përgatitjes së tokës jemi udhëhequr nga përshkrimi i stacionit, detyra e projektimit, pozicioni dhe afërsia nga rruga dhe qendra e banuar, **për t'i dhënë Krastës jo thjesht një sipërfaqe të pyllëzuar, por krijimin e një pylli me vlera ekologjike dhe turistike.**



Cupressus sempervirens L.)



Ilaja (*Quercus ilex* L.)

③

'Drurët dhe shkurret e Shqipërisë', 'Dendrologjia', 'Pyllëzimet artificiale dhe fidanishtet pyjore'

## SKEMA E PYLLËZIMIT/ MBJELLJES




Fig. nr. 2. Skema e pyllëzimit




Fig. 3. Përzierje e llojeve, bashkëshoqërime në grupe

### Metoda e pyllëzimit:

Do të jetë ajo me fidana në qeska plastmasi me tokë. Fidanat duhet të plotësojnë kushtet teknike sipas standartit 1798/87. (zv 1798/82, grupi K-81. KDU 634.O.23), Miratuar më 1.1.1998.

### Mënyra e përgatitjes së tokës:

Nisur edhe nga eksperiencia e viteve të kaluara; për mbjelljen e pishës do të hapen gropat me madhësi 50x50x50cm. Dheu i gërmuar do të vendoset i ndarë nga njëri-tjetri (në shtresa). Në mbjelljen e fidanit shtresa e sipërme hidhet në fund të gropës. Mbjellja do të bëhet duke i mbushur gropat plotësisht me dhe' dhe duke e ngjeshur mirë atë rreth fidanit, pa dëmtuar sistemin rrënjor. (Fig. nr. 4).




Fig. 4. Hapja e gropave dhe mbjellja e fidanave

### Koha e kryerjes së punimeve:

Përgatitja e tokës mund të bëhet gjatë gjithë vitit, duke përjashtuar muajt me thatësi (korrik dhe gusht). Periudha më e mirë është në tetor-nëntor dhe shkurt-mars. Gropat do të hapen disa kohë përpara mbjelljes, me qëllim që ato të rrihen nga agjentët atmosferikë.

Mbjellja e fidanave do të kryhet në periudhën e pushimit të vegjetacionit. Mund të fillojë në muajin nëntor dhe të vazhdojë deri në 20 dhjetor, por mund të kryhen edhe në pranverë me largimin e ngricave deri në 15 prill. Çdo vonesë në mbjelljet e vjeshtës ose të pranverës, mund të sjellë pasoja në përqindjen e zënies së fidanave.

## KAPITULLI I KATËRT

### **Mënyra e pyllëzimit:**

Për efekt të kushteve të vështira të tokës, në objektin e pyllëzimit, mënyra e mbjelljes do të jetë ajo me fidane në qeska plastmasi. Ndërsa për caktimin e skemës dhe dendësisë së mbjelljes së fidanave do të udhëhiqemi nga kërkesat e llojeve dhe kushtet mjedisit, por edhe nga normativat e miratuara në numurin e fidanave/ha në objektin e pyllëzimit. Për rastin tonë numuri i fidanave/ha me llojin pishë mesdhetare do të jetë 1666 fidana/ha dhe skemë pyllëzimi 3x2m, të alternuara me llojet Selvi, Tunjë dhe Ilqe (më rezistentë karshi erës), në breza ose në grupe sipas përbërjes dhe përzgjedhjes së tokës.

**Në lartësinë 190-195m mbi nivelin e detit në objekt, në drejtimin horizontal sipas vijës rrushkulluese/izopseve do të lihet një brez 5-8m gjërësi, i papyllëzuar, i cili do të shërbejë si brez për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi (MNZSH).** Ndërsa, në të dy anët e koridorit do mbillen llojet Selvi dhe Tunjë, të cilët do të shërbejnë edhe si mure të gjelbërt ndaj faktorëve natyror. Në kufirin ndarës të brezit me pyllëzimin do të hapet një hendek zjarrpritës dhe më vonë pas një studimi dhe projektimi kompleks ky brez do të shërbejë si rrugëkalimi për zjarrfikëset, por edhe si brez zjarrpritës i zjarrit në brendësi të pyllit (Fig. nr.5).

### **Mënyrat e punimit të tokës:**

Sipërfaqja pyjore në Krastë, sipas pjerrësisë ndahet në dy kategori:

- sipërfaqe boshe me pjerrësi mbi 10°.
- sipërfaqe boshe me pjerrësi nën 10°.

Në sipërfaqen me pjerrësi nën 10°, punimi i tokës do të bëhet me gropa 50cm x 50cm x 50cm.

### **Punimi i tokës me gropa:**

Për pyllëzimin e tokës së degraduar do të aplikohet punimi me gropa. Qëllimi është që të pyllëzohet e gjithë sipërfaqja e xhveshur, qoftë kjo tokë të sheshtë, me pjerrësi të vogël, si dhe vendet shkëmbore të mundshme për t'u pyllëzuar. Para piketimit dhe hapjes së gropave do të bëhet prerja dhe largimi i shkurreve në gjithë sipërfaqen. Ndërsa speciet e përfshira në Urdhërin e Ministrisë Mjedisit nr. 1280, datë 20.11.2013 'Për miratimin e listës së kuqe të florës dhe faunës shqiptare', si Vidhi, Lofata, Dëllënja e kuqe apo lloje tjera dekorative do të ruhen pa u prerë, përjashtoj rastet kur është e domosdoshme. Shkurret e prera në rast se nuk gjejnë përdorim, të grumbullohen në proskën në anë të objektit, të vendosen në rreshta sipas izopseve, ose në kohë të përshtatshme, të digjen. Nisur nga eksperiencia e viteve të mëparshme gropa do të hapen me madhësinë dhe teknikën e përcaktuar në (fig. nr. 4). Mundësisht të ruhet skema 3x2m, duke respektuar largësitë e mbjelljes ndërmjet fidanave dhe rreshtave, të udhëhequr nga kërkesat ekologjike të llojeve, në mënyrë të veçantë nga temperamentit i tyre, forma e zhvillimit të kurorës, sistemi rrënjor dhe intensiteti i rritjes në lartësi të drurit.

## PUNIMET PËR MIRËBAJTJEN E KULTURAVE

### ① Shërbimet kulturale:

Për të pasur rezultate më të sigurta, zhvillim sa më të mirë, përqindje të lartë në zënie e fidanave është e domosdoshme kryerja e shërbimeve kulturale në tre vitet e para pas mbjelljes. Këto do të konsistojnë në tre prashitje në vitin e parë, dy prashitje vitin e dytë dhe një prashitje vitin e tretë. Prashitja do të bëhet me rreze 0.3m. dhe thellësi 10-15cm, në periudhën prillë-qershor.

### ② Zëvendësime:

Duke pasur parasysh kushtet e mjedisit dhe mundësinë e dëmtimit të fidanave nga faktorë të ndryshëm natyror, parashikojmë që objekti të ketë një zënie mbi 80% të numurit të fidanave të mbjellë. Ndësa, zëvendësimi i fidanave të tharë do të bëhet deri 2 vitet e para. Kjo do të bëhet në bazë të të dhënave që do të rezultojnë nga verifikimi i zënieve që bëhet në pranverë dhe vjeshtë sipas Udhëzimit nr. 1, datë 2.8.2000.

### ③ Ripërtëritja natyrore nëpërmje farës:

Mbështetur nga përvoja e derisotme është provuar se ripërtëritja natyrore ose artificiale, nëpërmjet farës është e garantuar. Prandaj meqenëse brenda parcelës do të mbeten grumbull drurësh, do të aplikohet ripërtëritja sipas kësaj teknike. Në çeltirat e krijuara nga thyerja, djegia apo shkulja e drurëve, konditave suplementare të dritës dhe nxehtësisë nën masivin e rralluar, farërat gjejnë kushte mjedisi të mira për mbirjen dhe zhvillimin e filizërisë, e cila instalohet shpejt, mbasi përfiton kushte relativisht të mira në sipërfaqen e tokës.

### ④ Masat mbrojtëse:

Sic theksuam edhe në detyrën e projektimit, meqenëse objekti në pjesën e poshtme të tij është i goditur nga fenomeni përrrenjësor, duhet të merren masa mbrojtëse kundër formave aktive të erozionit, mbrojtjes nga kullotja, si dhe krijimit të kushtve për ripërtëritjen natyrore nëpërmjet farës. Prioritet do t'i jepen masave preventive për mbrojtjen nga zjarri, duke paralajmëruar qytetarët me mbishkrime, tabea, fletëpalosje dhe mjete tjera propogandistike, gadishmëria e veglave dhe mjeteve të punës për shuarjen e zjarrit, hendeqeve ose rrugëve zjarrpritëse në brendësi të pyllit, prerja/shkulja e shkurreve dhe pastrimi nga bimësia barishtore, respektimi i dispozitave që parasheh ligji për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri, etj, pa lënë pas dore monitorimin e gjendjes shëndetsore të pyllzimeve, si dhe masave profilaktike kundër dëmtuesve apo sëmundjeve. Krahas masave silvikulturore të kujdesimit duhet planifikuar një kujdestar me detyrë mbrojtjen nga kullotja, zjarret, sëmundjet dhe dëmtues të tjerë.

### Profil i objektit dhe koridor për MNZ, me elementët përkatës të dimensionuar




Fig. nr.5. Brez mbrojtës dhe koridor horizontal për mbrojtjen nga zjarri



**BASHKIA ELBASAN**

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PYJORE, BUJQËSISË, VETERINARISË DHE MJEDISIT

## MASAT TEKNIKO-ORGANIZATIVE QË DO TË MERRREN PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI



### SHPIJEGUES:

EP: 'Zaranikë'  
Emri i vendit: Krasta madhe  
Sipërfaqja: 185.5 ha.  
ZK: 8527  
Pronësia: Bashkiake  
Lloji: Pishë mesdhetare  
Distanca: 5km

- Pikë vrojtimi
- Rrugë auto për automjete/zjarrfikëse
- Sipërfaqe pyjore e rrezikuar nga zjarri

### Masa tekniko-organizative që do të ndërmerren:

1. Hartimi i planit vjetor të masave për mbrojtjen nga zjarri.
2. Vrojtimin dhe zbulimin e zjarrit shpejt në kohë dhe njoftimi i strukturave përgjegjëse.
3. Ndërtimin e brezave ndarës dhe koridoreve për MNZ.
4. Organizimi transportit të zjarrfikësve dhe njerëzve që do të marrin pjesë në fikjen e zjarrit.
5. Furnizimi me mjete dhe pajisjet e duhura.
6. Rekrutimin dhe trajnimin e skuadrave zjarrfikëse.
7. Përcaktimin e rrezikut të zjarrit.
8. Skema lajmërimi, harta treguese për rrugët e lëvizjes.

Specialisti i Menaxhimit

*Qemal Pjoka*

Përgj. sektorit të Admin.-Menaxhimit të PK  
Jakov Bodurri

DREJTORI  
Shpëtim Gullhaj



## Aspekte ekonomiko-finaciare.

Per arritjen e qellimit dhe objektivave te propozuara ne projekt eshte plotesisht i mundeshm si gurimi i mjeteve financiare fuqise punetore, sigurimi i materialit mbjelles etj. Financimi I ketij projekti do te kete ndilkim social dhe ekonomik ne punesimin e banoreve ne afersi per nje periudhe gati njevjecare, por mbi te nitha do te krijoje nje siperfaqe te konsiderueshme pyll park natyror ne funksion per pushimin, arzetimin dhe shlodhjen e qytetareve te qytetit te Elbasanit.

### Llogaritja e materialit mbjelles:

- Skema qe do te perdoret: 3 m x 2 m.
- Numuri i fidanaveper 1 ha.: 1 666 fidana
- Siperfaqja qe do te pyllezohet: 10.35 ha
- Numuri i fidanave per pyllzimin e objektit: 17243 fidana
- Numuri i fidanave per zevendesimin e fidanave te thare (20%): 3382 fidana
- Mbjellja do te behet me fidana pishë mesdhetare, Ilqë, Tunjë, Selvi me moshe 1-2\_vjeçare, ne qeska, ne perputhje me kerkesat cilesore dhe teknike te fidanave te pajisur me çertifikate fitosanitare sipas STASH 1798/87. (zv 1798/82, grupi K-81. KDU 634.0.23), Miratuar ne dat. 1.1.1998. Fidanet duhet te jene ne qeska plastmasi, me 'buke dheu', sistem rrenjor te zhvilluar mire, me ngjyren karakteristike te kurores, trup te drunjezuar te drejte, pa demtime, me sythe te zhvilluar normalisht. te paprekur nga semundjet, insektet, ngricat dhe shenja tharjeje nga mungesa elageshtires.

### Analiza e risbku:

Periudha e zgjatur e mungeses se reshjeve, teperaturat extreme, renia e zjarreve dhe demtimi nga kullotja e gjese se gjalle. mund te ndikojne ne perkeqsimin e treguesve teknik ne objekt, te cilet konsiderohen si faktor rrishtu per arritjen e objektivave.

Ne te tilla raste, Struktura e Sherbimit pyjor do te marri masat tekniko - organizative per zbutjen e e tyre, siç pershkruhen ne kapitujt paraardhes dhe masave preventive te parashikuara ne projekt.



## **Konkluzione dhe rekomandime:**

---

- Përpara të çdo procesi pune të bëhet kontrolli i teritorit për lëndë plasëse, granata të paplasura dhe mbetjeve ushtarake të groposura ose të fshehura në vitin 1997.
- Nga historiku dhe eksperiencia e mëparshme, llojet e parashikuara për mbjellje garantojnë zhvillimin normal të tyre.
- Punimet do të kryhen në zbatim të kërkesave teknike me korrektësi nga specialistë dhe punëtorë me përvojë.
- Fidanat duhet të plotësojnë standartet, të çertifikuar dhe në gjendje të mirë shëndetsore.
- Në grumbullin e ri që do të krijohet duhet të planifikohen shërbime kulturale dhe kujdesime.
- Pas mbjelljes të fidanave duhet të merren parasyshë dëmtimet nga faktor njerëzor dhe natyror.
- Krahas ripyllëzimeve, kujdes duhet të tregohet ripërtëritjes natyrore nëpërmjet farës.
- Meqenëse banorët e zonës mbarështrojnë blektori, duhet arritur konsensusi për ndalimin e kullotjes në objekt për një periudhë pesëvjeçare, si dhe krijimi i kushteve për ripërtëritjen nëpërmjet farës.
- Përveç masave për ndalimin e kullotjes për pesë vjet, prioritet do t'i jepet monitorimit të gjendjes shëndetsore të pyllëzimeve, si dhe masave profilaktike kundër dëmtuesve apo sëmundjeve.
- Për këtë arsye duhet planifikuar një punëtor mirëmbajtjeje e shërbimi me detyrë për mbrojtjen nga kullotja, zjarret, sëmundje dhe dëmtues.
  
- Punimet ulin dendësinë e mbulesës bimore, qoftë kjo drunore ose barishtore, për pasojë rrjedhjet sipërfaqësore keqsojnë bilancin ujor.
- Ndryshimi i biodiversitetit nga aktivitetet pyjore si; pyllëzimi, etj, krijojnë kushte për zhdukjen e specieve hijedashëse dhe ç'faqien e atyre dritëdashëse dhe anasjelltas. Ndonjëherë kjo mund të jetë me pasoja të mëdha, sepse mund të zhduken edhe specie të rralla.
- Mbrojtja e tokës nga erozioni dhe sedimentet, përveç masave zbutëse të fenomenit të erozionit, sipërfaqet pjerrësi të madhe duhet të trajtohen si pyllë mbrojtës i tokës nga erozioni.
- Migrimi i popullatave të kafshëve dhe i shpendëve është i lidhur me kushtet e reja që krijohen nga zbatimi punimeve.